

Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës
Konferenca “Universiteti, politika dhe vlerat e arsimit të lartë”
Prishtinë, 13 shkurt 2020

Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, panelist
Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan
Rektor

Arsimi i Lartë dhe politika (2020)

Hyrje tematike dhe metodologjike

Nga gjysma e dytë të shekullit XX dhe deri tani në periudhën e internetit, arsimi i shoqërisë ka rimarrë pozitiv të lartë në prioritetet e shoqërive, ngjashëm me periudhën e Renesancës dhe të Iluminizmit. Shembulli i Irlandës, i Finlandës dhe i ndonjë vendi tjetër janë të njohur se si përmes politikave të mira arsimore një vend dhe një komb mund të ngritët e të zhvillohet. Arsimi sot është interes nacional për secilën shoqëri moderne.

Si e trajtojnë politikën dhe qeveria e Kosovës arsimin e lartë? Duke qenë shoqëria e Kosovës “në zhvillim”, domosdo që diskutimi i politikave arsimore është me prioritet. Gati të gjithë aktorët pajtohen se arsimi është prioritet. Por, nga pajtimi verbal deri te ndarjet buxhetore dhe planet konkrete është një det i tërë.

Në këtë punim do të paraqesim vetëm tri aspekte të problemit, të fokusuar në arsimin e lartë në Kosovë, veçanërisht në universitetet publike¹:

- a) aspekti i komunikimit: si komunikojnë universitetet dhe qeveria?
- b) politikën qeveritare për arsimin, ku mëtojmë të përgjigjemi në pyetjen: cili është vizioni i qeverive të Kosovës për arsimin?
- c) politikën praktike të qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ndaj universiteteve publike dhe mëton të përgjigjet në pyetjen: si MASHT menaxhon me arsimin e lartë në KS?

Në fund të punimit do të japim edhe disa rekomandime.

Qasja jonë është kritike: politikën qeveritare në Kosovë duhet të orientohen shumë më tepër kah arsimi. Për të argumentuar hipotezat dhe pyetjet e shtruar janë përdorë: metoda e analizës, e përshkrimit, e interpretimit dhe e sintezës, por duke u shërbyer shkarazi edhe me analizën e diskutit.

A. Komunikimi universitete-qeveri

Komunikimi i deritashëm universitete-qeveri ka qenë, kryesisht, i njëkahshëm: **qeveri → universitete**. Për shembull:

- gjatë pesë vjetëve të ekzistimit, UKZ vetëm një herë ka marrë pjesë në dëgjimet buxhetore të Ministrisë së Financave, në vitin 2016, dhe vetëm atë herë ka mundur ta negociojë buxhetin e vet me MF. Të gjitha herët e tjera UKZ ka dërguar një kërkesë buxhetore në MASHT dhe gjithçka tjetër MASHT e ka zhvilluar pa e pyetur UKZ (**shih dëgjimet buxhetore?**);

¹ Arsimi i lartë në Kosovë rregullohet nga Ligji nr. 04/l-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Universitetet publike financohen nga Buxheti i shtetit, përmes Kuvendit të Kosovës ose Ministrisë së Arsimit. Ka shtatë universitete publike. Ekziston edhe sektori privat, i organizuar në “kolegje”.

- Vendimi për llojin e certifikatës dhe kompanitë që i japin ato për njohjen e gjuhës së huaj në studimet e masterit dhe detyrimin që studentët nuk pranohen në studime pa një certifikatë të tillë;²
- Hartimi i standardeve për akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë, përkatësisht Manuali i Akreditimit (2018), është bërë pa konsultime paraprake me Institucionet e Arsimit të Lartë; është mbajtur vetëm një punëtori njëditore, në të cilën universitetet janë njoftuar me përmbajtjen e dokumentit.³

A ka ekzistuar tendenca e komunikimit universitete-qeveri? Po, por pa sukses.

Për shembull:

- Në dy mandate të ministrave të MASHT, si rektor i UKZ po edhe në emër të katër universiteteve publike kam kërkuar zyrtarisht që Statuti i UKZ dhe i dy universiteteve të reja të dërgohet në Kuvendin e Kosovës për miratim dhe asnjëri ministër nuk e ka bërë;
- Konferenca e Rektorëve e ka ftuar ministrin e fundit të MASHT për të marrë pjesë në takimin e Konferencës dhe ai ka refuzuar gjithmonë ta bëjë këtë;
- Pavarësisht ftesës së Konferencës së Rektorëve që MASHT, AKA dhe universitetet publike të ulen dhe t'i diskutojnë problemet me rastin e krizës së akreditimit të dhjetëra programeve studimore në vitin 2018, nuk pati komunikim të tillë, përkundrazi, komunikimi u zhvillua publikisht, me një diskurs gati armiqësor.⁴

Përfundim për komunikimin: komunikimi universitete publike-qeveri (MASHT) kurdo që ka ndodhur, ka qenë i njëanshëm, pra pa feed back. Ka folur vetëm njëra palë, ose që të dyja, në kanale të ndryshme dhe pa feed back. Ligji për Arsimin e Lartë ka krijuar një trekëndësh partnerësh të pavarur, sa do me përgjegjësi të ndryshme, për funksionimin e arsimit të lartë: Ministria e Arsimit-Agjencia e Kosovës për Akreditim-Universitetet. Ky trekëndësh nuk ka funksionuar, sidomos në katër vjetët e fundit. Pak a shumë ngjashëm ka qenë edhe komunikimi me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (shih më poshtë).

B. Politikat zhvillimore qeveritare në arsimin e lartë- çështjet buxhetore

Shtylla e parë e *Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (2016)* është “Kapitali njerëzor”, brenda të cilit qeveria nënkupton edhe arsimin.

Por, vendosja “prioritet numër një” dhe masat përcjellëse janë të kundërta.

Të shohim:

1. Në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (2016)*⁵, fjala universitet përmendet 5 herë, në funksione dytësore. Asnjë paragraf nuk flet për arsimin universitar. Sa për krahasim, në të njëjtin dokument, fjala “infrastrukturë” përdoret 167 herë, në kuptim të ngushtë. Sipas këtij dokumenti shtetëror, zhvillimi pesëvjeçar i Kosovës mbështetet në katër shtylla kryesore: 1. kapitali njerëzor; 2. qeverisje e mirë dhe sundim i ligjit; 3. industri konkurruese; 4. infrastrukturë.

² Administrative Instruction (GRK) No.03/2018 for foreign languages in the study program of the second or third cycle, was approved on 33 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.16/33, date 28.02.2018;

³ KAA Accreditation Manual – July 2018, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/accreditation/guidelines-for-s-e-reports>

⁴ Konferenca e Rektorëve “Kërkesë për veprime urgjente në mbrojtjen e sistemit të arsimit të lartë publik nga degradimi”, Janar 28, 2019, <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/kerkesa-e-konferences-se-rektoreve-per-veprime-urgjente-ne-mbrojtjen-e-sistemit-te-arsimit-te-larte-publik-nga-degradimi/>; “Reagim i KSHC ndaj Konferencës së Rektorëve”, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/component/content/article/98-kaa-articles-2/lajmet/396-njoftim22012019>

⁵ National Development Strategy 2016 – 2021, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

Fjalja që e përmbyllë filozofinë e katër shtyllave është: “Këto shtylla bëjnë që kjo të jetë një strategji që premtion Punë, Ligj, Afarizëm dhe Ndërtim (PLAN).”⁶ Pra, arsimit nuk është qëllim, është vetëm vegël.

Si po shihet, arsimit, dija, shkenca, hulumtimi janë përfshirë brenda shtyllës së parë “kapitali njerëzor”, i përkufizuar më poshtë si “fuqi punëtore e aftë”⁷ dhe kjo e paraqet më mirë se gjithçka vizionin shumë të ngushtë të politikës për universitetet dhe arsimin në përgjithësi.

2. Të shohim tash ndarjet buxhetore për vitet 2015-2019 në arsim, dhe për krahasim, edhe në Ministrinë e Infrastrukturës:

Buxheti	MASHT	Paga dhe mëditje	MI (Min. Infrastr.)	Paga dhe mëditje
2015	46,343,537	13,894,269/29%	175,503,650	1,495,224 /0,85%
2016	45,545,415	14,939,774	182,956,552	1,808,393
2017	47,287,848	15,931,068	277,662,774	1,718,796
2018	58,003,626	17,286,141	304,572,759	1,874,604
2019	73,238,321	19,815,991	301,487,752	1,925,977

Burimi: Tabelat e përshtatura nga Buxheti i Kosovës për vitin 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, (<https://qzk.rks-qov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10996>), etj.

Duhet shtuar një sqarim: 29% e këtyre parave për MASHT janë paga! Asnjë ligj ekonomik nuk parasheh investime të vogla e fitime të mëdha! Rezultati është i barabartë në radhë të parë me investimet. Sipas këtyre tabelave qeveria për vite me radhë ka investuar disa herë më shumë në infrastrukturë se në arsim, prandaj edhe rezultatet në arsim janë të këtilla çfarë janë. Sot në Kosovë pa dyshim që kemi autostradat më të mira në rajon, po fatkeqësisht shkollat ndoshta më të këqija.

C. Politika dhe arsimit i lartë

Kjo është qasja tjetër nga që folëm deri më tash: është qasja e partive politike dhe e grupeve të tjera të interesit ndaj arsimit të lartë, qasje e njohur me termin “politizim i universiteteve”.

Këtu do të prezantohet disa prej këtyre veprimeve ndikim-këqija në arsimin e lartë.

- *Tendenca e MASHT e shfaqur në fillim të vitit 2018 me hartimin e një dokumenti, të quajtur “Studim i fizibilitetit” për universitetet publike.* Ministri i MASHT krijoi një grup, me legjitimitet formal dhe akademik të dyshimtë, për të hartuar një dokument në të cilin do të vlerësohej se cilat universitete duhet t’i ketë Kosova e cilat duhet të mbyllen. Veprimi që jo-legjitim sepse vlerësimin dhe vendimmarrjen për ekzistimin e universiteteve publike e merr një gamë e gjerë e shoqërisë, shumë hisedarë, e në radhë të parë vetë universitetet publike, qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, e jo një grup i ngushtë i ministrit të MASHT-it. Fatmirësisht, dokumenti përfundoi pa u zyrtarizuar (nuk u dërgua as në qeveri e as në Kuvend për miratim), pasi MASHT dështoi ta argumentojë fuqishëm. Në këtë qasje të pushtetarëve, universitetet publike pësuan, por edhe mësuuan shumë, mbi të gjitha, mësuuan se duhet të jenë të pavarura në vendimmarrje dhe në asnjë milimetër nuk duhet të tërhiqen nga vendimmarrja që u takon me ligj.⁸

⁶ National Development Strategy 2016 – 2021, pg. 6.

⁷ National Development Strategy 2016 – 2021, pg. 6.

⁸ “MASHT propozon reduktimin e numrit të universiteteve publike (...) Grupi punues i formuar nga Ministria e Arsimit, i cili është marrë me propozimet konkrete për profilizimin e universiteteve publike, ka dorëzuar raportin në Qeveri dhe në Komisionin Parlamentar për Arsim.” <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=328701>

- Shfaqja e dytë e politizimit të arsimit është ndërhyrja e MASHT në Këshillin Shtetëror të Cilësisë në vitin 2018, shkarkimi dhe zgjedhja e anëtarëve të rinj të KSHC.⁹ Pasojat e kësaj ndërhyrje janë të shumta, por dy janë kryesoret:
 - në janar të vitit 2019 KSHC mbylli me procedurë të dyshimtë ligjore mbi 40 programe studimore të universiteteve publike dhe në anën tjetër lejoi me kritere të dyshimta disa dhjetëra programe studimore të disa kolegjeve private.¹⁰
 - përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës nga EQAR¹¹ dhe nga ENQA (2019).¹²
- Shfaqja e tretë e këtij politizimi është emërimi i militantëve të partisë nëpër Këshillat Drejtues të universiteteve publike. Kjo punë u bë dy herë në të gjitha universitetet publike: së pari në vitin 2018 dhe së dyti gjatë periudhës kur qeveria që në dorëheqje, pra në fund të vitit 2019. Ministri i MASHT veproi në kundërshtim të plotë me ligjin dhe me statutet e universiteteve publike duke emëruar në KD të Universiteteve persona që nuk i plotësojnë kriteret për atë pozitë, por që janë militantë partiakë.¹³
- Shfaqja e katërt e këtij politizimi është mos-procedimi i statuteve të katër universiteteve publike për miratim në Kuvendin e Kosovës. Aktualisht, katër universitete publike ende nuk e kanë dokumentin e tyre themeltar, Statutin, të miratuar në Kuvendin e Kosovës. Kjo është pengesa themelore në pavarësimin administrativ e financiar të universiteteve publike.
- Shfaqja e pestë është mos-pavarësimi financiar i të gjitha universiteteve të reja publike. Buxhetet e pesë universiteteve publike në Kosovë (Gjilani, Prizreni, Gjakova, Peja dhe Mitrovica) janë ende pjesë e buxhetit të MASHT, e do të duhej të jetë i pavarur, pjesë e Buxhetit të Kosovës i cili miratohet në Kuvendin e Kosovës. Duke qenë kështu, universitetet publike nuk mund të kenë zhvillime të theksuara¹⁴.

D. Arsimit i lartë, kultura nacionale dhe pseudo-globalizmi

Që nga paslufta e këndeje, në emër të multi-etnicitetit të shoqërisë kosovare, u shfaq tendenca latente për marginalizimin e kulturës nacionale shqiptare. Kjo tendencë është orientuar në radhë të parë kundër Universitetit Publik të Prishtinës, i cili për 40 vjet ka qenë burim i revolucionit kombëtar për çlirimin e Kosovës. I pari e pat shfaqur këtë qasje UNMIK, në vitin 2000, kur kërkoi mbylljen e Institutit Albanologjik të Prishtinës, me arsyetimin e çoroditur se tash nuk duhet të ketë një institut për një kulturë nacionale por një institut multikulturor.

Sulmet e pabaza që bëhen edhe sot mbi kulturën universitare shqiptare, mbi gjithçka që ndërlidhet me universitetin dhe të kaluarën e tij, i shoh të lidhura drejtpërdrejt me këtë shfaqje anti-kulturore të UNMIK. Përdhosja e cdo vlere universitare, në emër të luftës për cilësi, është antivlerë dhe asgjë më shumë. Kërkesa e artikuluar në dy vjetët e fundit në opinionin publik nga disa opinion-bërës, se është më mirë të mbyllen të gjitha universitetet dhe të krijohen nga fillimi të rejt¹⁵, është kërkesë për shkatërrim dhe jo kërkesë për ndërtim.

⁹ Shih Vendimin nr. 198/01B të datës 25.09.2017 për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/vendim-ref-nr-198-01b-per-shkarkimin-e-kshc-se.pdf>

¹⁰ <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/download/2015-09-02-09-42-16/public-institutions>

¹¹ Exclusion of the Kosovo Accreditation Agency (KAA) from the Register, Ref. C22 Ver. 2.0, Date 2018-02-27, https://backend.deqar.eu/reports/EQAR/2018-02_Exclusion_Decision_C22_KAA.pdf

¹² Membership of KAA in ENQA, Bern, 1 October 2019, https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/Letter-ENQA-to-KAA_Sep-2019.pdf

¹³ Ligji nr. 04/I-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Neni 18, prg. 2.

¹⁴ Ligji nr. 06/I -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, fq. 22-23, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

¹⁵ Shkëlzen Gashi nga OJQ Adminvere: "Qeveria që vjen duhet me ndërmarr masa radikale pasi gjendja është shumë radikale, dhe duhet të mbyllen këto universitete, që janë hapur në kohën e Thaçit."

<https://www.gazetaexpress.com/gjendja-ne-arsimin-universitar-mbetet-e-rende-vettingu-i-domosdoshem/>

Ministri i Arsimit Shyqiri Bytyqi: "Këto universitete mund të jenë dy universitete në tërë Kosovën, të tjerat si kampuse apo degë të universiteteve, por gjithmonë duke i rishikuar programet aktuale që ekzistojnë, nuk do të ketë asnjë ndërprerje të programit të studentëve aktualë."

Ne duhet t'i ndërtojmë universitetet më cilësore përmes një procesi të evoluimit dhe jo përmes revolucioneve kulturore.

E. Sugjerime për veprime:

1. *Arsimi-prioritet:* Qeveria ta shpallë prioritet arsimin. Dhe të silltet me përgjegjësi ndaj prioritetit: të krijojë politika të qarta, afatgjata, për arsimin. Të ndryshojë qasjen buxhetore ndaj arsimit të lartë.
2. *Zgjidhja e problemeve infrastrukturore:* Shumica e universiteteve publike ballafaqohen me probleme elementare të hapësirës për aktivitetin akademik. Qeveria duhet ta trajtojë këtë çështje me prioritet dhe ta tejkalojë për një kohë të shkurtër. (Pengesat të mëdha u shfaqën në moskrijimin e hapësirave të mjaftueshme ose elementare për uniuniversitetet publike, e në anën tjetër duke kërkuar nga ato standarte të larta (Standardi 9:6, 10:6, 10:7 etj.), për castin të përealizueshme. Agjencia Akreditimit i mbylli për një vjet tri universitete publike duke ua ndaluar pranimin e studentëve në vitin e parë kryesisht për shkak të mospërmbushjes së disa kushteve hapësinore).
3. *Financimi i arsimit të lartë edhe në bazë të performancës:* Institucionet e arsimit të lartë financohen njëtrajtshëm dhe buxheti që u ndahet atyre, kryesisht mbulon pagat e punëtorëve. Kjo pamundëson zhvillimin e universiteteve duke dekurajuar performancën e tyre në hulumtime. Financimi i universiteteve publike duhet bërë në dy kategori:
 1. Pagat dhe investimet kapitale
 2. Pjesa e buxhetit në bazë të performancës, e fituar përmes projekteve të ndryshme.
4. *Fondi për hulumtime shkencore e kulturore:* Fondi aktual i MASHT për shkencë është simbolik. MASHT dhe universitetet publike duhet të krijojnë politika dhe praktika të qarta për hulumtimin shkencor në universitetet publike dhe përgjithësisht në Kosovë. Kosova është e fundit në vendet e rajonit në qasje në fondet e Bashkimit Europian për hulumtime shkencore. Duhet ta përgatisim stafin tonë për një konkurrencë të tillë dhe një nga mënyrat për këtë është rritja e fondit për hulumtime shkencore dhe qartësimi dhe lehtësimi i politikave për qasje në atë fond. Po ashtu, Qeveria e Kosovës duhet të ketë interesa nacionale në hulumtimet shkencore e kulturore. Një pjesë të këtij fondi duhet ta orientojë kah këto interesa, përmes projekteve të ndryshme. Përmes këtij fondi për hulumtime shkencore e kulturore rritet performanca e universiteteve publike edhe në fondet e BE.
5. *Universitetet publike dhe Agjencia e Akreditimit:* Institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private, në njërin anë dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës, në anën tjetër, duhet ta ndryshojnë mënyrën e bashkëpunimit të deri tashëm, për të qenë më të suksesshëm të gjitha palët dhe për ta rikthyer AKA në ENQA dhe EQAR. Së pari, të gjitha palët janë partnerë në arsimin e lartë me përgjegjësi të ndryshme, dhe AKA duhet ta ndryshojë praktikën e të qenit xhandar i universiteteve. Ka një ndryshim pozitiv në muajt e fundit. Partnerët duhet të organizojnë tryeza debutuese të shpeshta, si këto që po bën Konferenca e Rektorëve, për t'i trajtuar problemet dhe gjetur zgjidhjet e përshtatshme. Së dyti, të gjitha palët duhet të synojnë standardet europiane në arsim, por nuk duhet të krijohen standarde iluzore dhe të paarrtshme, në emër të cilësisë. Ka disa standarde të tilla në Manualin e Akreditimit (2018), të mjaftueshme për të vënë note jo-kaluese për scilin universitet publik në Kosovë dhe për secilin profesor. Kjo metodologji është dështim dhe asgjë tjetër. Një dështim i tillë është hartimi i *Manualit të Akreditimit* (korrik 2018). Një pjesë e këtyre standardeve janë kështjella në ajër dhe një pjesë janë të kundërthënshme. Duhet organizuar një punëtori e të gjithë hisedarëve për t'i ridiskutuar ato standarde.

Ne duhet të nisemi nga gjendja faktike në institucionet e arsimit të lartë dhe të mbërrijmë te standarde më të larta, e jo të vizatojmë kështjella në ajër dhe të presupozojmë se duhet të mbërrijmë atje.

6. *Arsimi i lartë dhe institucionet private të arsimit të lartë:* Institucionet private të arsimit të lartë duhet dhe mund të luajnë rol shumë më të madh në konkurrencën dhe cilësinë e arsimit të lartë. Qeveria dhe universitetet publike duhet t'i përkrahin në këtë drejtim.

Por duhet të ndryshohet ligji për regjistrimin dhe aktivitetin e tyre.

Institucionet private të arsimit të lartë **regjistrohen si organizata biznesore**, dhe fitimet e tyre mund t'i investojnë në cilëndo veprimtari profitabile. Kjo ka ndikuar që shumica e tyre ta shohin ekskluzivisht profitin si qëllim kryesor.

Si mund të ndryshohet kjo perspektivë? Duhet ndërmarrë dy veprime:

1. Regjistrimi i Institucioneve Private të Arsimit të Lartë duhet të bëhet me Ligjin për Arsimin e Lartë, si Institucione të Arsimit të Lartë Jo Profitabile. Paratë e fituara nga studentët duhet t'i investojnë brenda institucionit të tyre të arsimit.
2. Institucionet private të arsimit të lartë duhet të kenë qasje në Fondin e qeverisë për hulumtime shkencore.

Vetëm atëherë kolegjet private do t'i konkurrojnë universitetet publike dhe do t'i detyrojnë të reformohen më shumë.

Në fund: Qeveria ta shpallë prioritet arsimin. Dhe të sillet me përgjegjësi ndaj prioritetit!

Dokumente dhe burime të cituara:

Administrative Instruction (GRK) No.03/2018 for foreign languages in the study program of the second or third cycle, approved on 33 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.16/33, date 28.02.2018;

KAA Accreditation Manual, July 2018, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/accreditation/guidelines-for-s-e-reports>;

Konferenca e Rektorëve “Kërkesë për veprime urgjente në mbrojtjen e sistemit të arsimit të lartë publik nga degradimi”, Janar 28, 2019, <https://www.uni-gjilan.net/lajmet/kerkesa-e-konferences-se-rektoreve-per-veprime-urgjente-ne-mbrojtjen-e-sistemit-te-arsimit-te-larte-publik-nga-degradimi/>;

“Reagim i KSHC ndaj Konferencës së Rektorëve”, <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/component/content/article/98-kaa-articles-2/lajmet/396-njoftim22012019>;

Republic of Kosovo, Government, Office of the Prime Minister, “National Development Strategy 2016 – 2021”, 2016, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf;

“MASHT propozon reduktimin e numrit të universiteteve publike (...)”, <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=328701>;

Vendimi nr. 198/01B, datë 25.09.2017 për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/vendim-ref-nr-198-01b-per-shkarkimin-e-kshc-se.pdf>;

<http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/en/download/2015-09-02-09-42-16/public-institutions>;

Exclusion of the Kosovo Accreditation Agency (KAA) from the Register, Ref. C22 Ver. 2.0, Date 2018-02-27, https://backend.degar.eu/reports/EQAR/2018-02_Exclusion_Decision_C22_KAA.pdf;

Membership of KAA in ENQA, Bern, 1 October 2019, https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/Letter-ENQA-to-KAA_Sep-2019.pdf;

Ligji nr. 04/I-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>;

Ligji nr. 06/I -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, fq. 22-23, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>;

Shkëlzen Gashi, OJQ Adminvere: “Qeveria që vjen duhet me ndërmarr masa radikale pasi gjendja është shumë radikale, dhe duhet të mbyllet këto universitete, që janë hapur në kohën e Thaçit.” <https://www.gazetaexpress.com/gjendja-ne-arsimin-universitar-mbetet-e-rende-vettingu-i-domosdoshem/>;

Ministri i Arsimit Shyqiri Bytyqi: “Këto universitete mund të jenë dy universitete në tërë Kosovën...” <https://www.gazetaexpress.com/lajme-masht-i-del-kunder-kryeministrit-per-universitetet-publike-493212/>